Lezhë, më 29.02.2024

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 29.02.2024, në orën 12:00, në sallën e bibliotekës "At Gjergj Fishta" Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë, për muajin Shkurt 2024.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës si dhe një projekt vendim shtesë për të cilin tha që ka kaluar dhe në komisionin përkatës.

- Ndue Luli: Kush është dakord me rendin e ditës?

Miratohet me 27 vota PRO, përveç z. Aleksandër Mekaj që nuk votoi.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që është projekt vendim "Për dhënien e mandatit si anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë z. Elton Martin Bilani"

Kush është dakord për dhënien e mandatit?

Miratohet me 27 vota PRO, përveç z. Aleksandër Mekaj që nuk votoi.

Vazhdojmë me projekt vendimin e dytë "Për dhënien e mandatit si anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë z. Argert Mark Përkola".

Kush është dakord?

Miratohet me 27 vota PRO, përveç z. Aleksandër Mëkaj që nuk votoi.

Vazhdojmë me projekt vendimin e tretë "Për dhënien e mandatit si anëtar i këshillit të Bashkisë Lezhë z. Erin Pjetër Gjoni".

Kush është dakord ?
Miratohet me 27 vota PRO, përveç z. Aleksandër Mekaj që nuk votoi.
- Kryetari ftoi tre këshilltarët e rinj të ngrihen në këmbë dhe lexoi formulën e betimit.
- Tre këshilltarët e rinj u betuan.
- Ndue Luli: Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës që është: "Informacion për punën dhe veprimtarinë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë".
Meqë çdo këshilltar e ka pasur materialin para, mendoj të fillojmë me pyetje, pastaj me diskutime në lidhje me materialin në fjalë.
Prezent kemi drejtorin rajonal të Sh.R.U.K. Lezhë.
- Donika Ndoj: Përshëndetje të gjithëve.
E kam parë materialin por do ishte mirë të ishte i përpiluar që t'i evidentonim problemet edhe si njësi administrative dhe jo kështu i përgjithshëm, se kështu vimë re që thotë: 24 orë ujë për çdo ditë të javës. Në fakt për Njësinë Zejmen due të pyes z. Maçi se si funksionon furnizimi me ujë, pasi ka qenë krijuar një tip gangrene. Për momentin ka njëfarë përmirësimi në furnizimin me ujë, por a janë të garantuar qytetarët se ky ujë është i pijshëm dhe që do të kenë furnizim jo vetëm në stinën e dimrit, por dhe gjatë stinës së verës. Faleminderit.

- Ndue Luli: Pyetje tjetër? Po zj. Marku.

- Afërdita Marku: Faleminderit. Kam lexuar raportin. Sa i përket pronësisë së aksionerve, siç dhe e keni sqaruar, 51% janë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, 30% Bashkisë Lezhë, 12% Kurbin, 5,8 Bashkia Mirditë. Keni bërë dhe një sqarim të të ardhurave dhe se sa keni arrit për të mbledhur. Unë kam një pyetje. A ke projekte të financuara nga qeveria e vendit tonë për përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm në Lezhë, në ato zona ku ke probleme? A ke ndonjë projekt të financuar nga vetë Ujësjellësi për të përmirësuar gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm? Gjithashtu, duke shfrytëzuar për mirë rastin që drejtori është prezent dhe prej një periudhe të konsiderueshme ke në menaxhim dhe Kurbinin e Mirditën, unë me ap informacion sa kam pytet i Kurbinit, ende është një zonë shumë problematike sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm dhe desha t'i bëj një pyetje drejtorit se dhe sa kohë duhet të presim që banorët e asaj zone ta kenë zgjidhur këtë problematikë. Unë e përshëndes ndërhyrjen te impianti i përpunimit të ujrave të ndotura, shtuar dhe faktin që është një projekt, i cili në zonën turistike të Shëngjinit, me gjë qfarë gjenerohet, kërkon një ndërhyrje urgjente. Në këtë pikë, unë mendoj

Kam dhe dakordësinë e të gjithëve, është Banka Gjermane për Zhvillim, të cilën duhet ta falenderojmë dhe të jemi mirënjohës, që në kushtet ku Bashkia Lezhë ka probleme të dukshme të furnizimit me ujë të pijshëm, janë pikërisht ata që ndërhyjnë dhe duhet t'i falenderojmë.
Gjithashtu jam plotësisht dakord me ndërhyrjen në ujësjellësat Mërqi - Rrabosht. Kam një pyetje të fundit, për zonën e Dajçit, kur parashikohet që të kemi një zgjidhje përfundimtare të furnizimit me ujë të pijshëm? Faleminderit.

- Ndue Luli: Po z. Jaku.

- Dod Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Unë kisha dy pyetje. Pyetja e parë është: Për Njësinë e Shënkollit a ka ndonjë projekt për fshatrat, që shumica e fshatrave vetëm e vetëadministrojnë ujin dhe çfarë mendohet të bëhet për këtë punë, posaçërisht se është një zonë mjaft e dendur me banime. Pyetja e dytë në lidhje me Shëngjinin. A do kemi prapë probleme sivjet për ujin e pijshëm që në pikun e turizmit mungon uji i pijshëm? Faleminderit.

- Ndue Luli: Pyetje tjetër? z. Marku.

- Agostin Marku: Pyetja e parë është: ku jemi me situatën e investimeve në proces? Çfarë problemesh ka? Kur përfundojnë? Si është menaxhuar dhe si është gjendja reale?

Pyetja e dytë: Dihet dhe duhet pak këtu se kanë detyrime shoqëritë deri në momentin e bashkimit. Sa janë këto detyrime për gjithsecilën shoqëri dhe sa ndikojnë në koston e përgjithshme detyrimet e Mirditës dhe të Kurbinit? Nuk kam për të na dhënë përgjigje për Mirditën e Kurbinin se janë këshillet bashkiake përkatës por duhet të dimë se sa ndikojnë për Lezhën. Çfarë merr përsipër Ministria përkatëse në momentin e bashkimit sepse ka 51% të aksioneve, nga këto detyrime ose borxhe të kapije si mund të themi. Diku thoni: humbjet teknike dhe administrative 36,76%. A nuk janë të larta këto humbje dhe si e keni menduar që t'i menaxhoni në të ardhmen? Dhe një pyetje tjetër - keni thënë për kostot operative, pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore zënë rreth 46,4% të shpenzimeve të përgjithshme. A është shifër e lartë kjo për një shoqëri aksionere? Kaq kisha.

- Ndue Luli: Po z. Tushaj.
- Pjetër Tushaj: Përshëndetje të gjithëve. Unë kam një pyetje për drejtorin. Na ka ardhë një broshurë biznesave në Shëngjin. Si do funksionojë?
- Ndue Luli: Po z. Ndreca.
- Erin Ndreca: Përshëndetje të gjithëve. Kisha një pyetje. Në Njësinë Administrative Ungrej,

në fshatin Kalivaç, para shumë viteve është ndërtuar një ujësjellës nga Komuna e asaj kohe dhe ai ujësjellës pas ca viteve, për mungesa të ndryshme, ka dalë nga funksioni. Tani, para pak ditësh, me iniciativa personale, kemi arritë me ca riparime të vogla, të sjellim ujë në qendër të fshatit. Dojë të dijë, meqë drejtorin dhe bashkinë i kemi të pranishëm, a është e mundur ose çfarë procedurash duhet të ndiqen që ky ujësjellës të përfshihet në drejtorinë qendrore të Ujësjellësit dhe të vendoset një person nga njësia administrative atje që të kujdeset dhe ta mirëmbajë? Faleminderit.

- Ndue Luli: ka ndonjë pyetje tjetër? S'ka. Atëherë fillojmë me përgjigjet e pyetjeve. Ju lutem z. drejtor, konçiz.

- Zef Maçi: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për ftesën. Respekt, konsideratë për ju, për mbështetjen dhe bashkëpunimin gjatë kësaj periudhe që keni ushtruar detyrën. Po filloj direkt me përgjigjet e pyetjeve. Këshilltarja Donika Nolaj pyet në lidhje me Ujësjellësin e Nj.A. Zejmen. Këto ujësjellësa janë projektuar nga Bashkia Lezhë dhe janë financuar nga buxheti i shtetit. Ujësjellësit janë të papërfunduar dhe janë drejt përfundimit. Kanë përfunduar pothuajse mbi 90% të punimeve, tani

Kanë mbetë aksesorët përfundimtarë të cilët do të çojnë ujësjellësin drejt marrjes në dorëzim. Mendojmë që me përfundimin e këtij investimi, të përmirësohet furnizimi me ujë në fshatrat Zejmen, Fllanë, Markatomaj, Spiten e Trosh.
Znj. Alfride Marku pyeti a ka projekte të financuara nga buxheti i Shtetit ose bashkia. dhe si qëndron situata në Bashkinë Kurbin.
Sigurisht që Bashkia Lezhë është interesuar vazhdimisht për të çuar drejt përfundimit furnizimin me ujë të pijshëm në të gjitha fshatrat e njësive administrative. Për fatin e madh, këtë vit jemi në axhendë të financimit Ujësjellësi i fshatit Dajç - projekti është realizuar nga Bashkia Lezhë dhe do të financohet nga buxheti i shtetit. Është bërë projekti për furnizimin me ujë të pijshëm në njësinë Kallmet për fshatrat Mërqi dhe Rraboshtë. Projekti është bërë nga Bashkia Lezhë dhe do financohet nga buxheti i shtetit këtë vit. Znj. Marku preku një ngjarje shumë të rëndësishme, pra Banka Gjermane për Zhvillim, Qeveria Zvicerane dhe Bashkimi Europian - Banka Europiane për Zhvillim po financojnë një projekt shumë të rëndësishëm për qytetin e Lezhës me iniciim nga Bashkia dhe mbështetur nga Qeveria Shqiptare. Investimi është strategjik sepse do prekë një

sërë proceseh në ujësjellës - kanalizime por më e rëndësishmja, furnizimi me ujë të pijshëm të qytetit të Shëngjinit, të lagjes Kodër-Marlekaj (Nënë Tereza), Gocaj - Kakariq, do përmirësohet kanalizimi i ujërave të ndotura në qytetin e Lezhës dhe çfarë është më e rëndësishme dhe risi, do realizohet projekti për mospërmbytjen e Lezhës. Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm të qytetit të Laçit - vuan furnizimin me ujë të pijshëm. Ka vetëm një orë e gjysmë ujë në ditë. Nga ana financiare kanë pasë detyrime marramendëse. Ujësjellësi Kurbin ka pasë rreth 14 mln dollarë borxhe. Ujësjellësi Mirditë ka pasë rreth 5 mln dollarë borxhe. Ndërkohë që Sh. U.K. Lezhë menaxhohet me të ardhurat e veta dhe nuk ka asnjë detyrim që nga viti 2010. Ne Shoqëria Rajonale U.K. Lezhë kemi hasur në vështirësi shumë të mëdha me këto 2 kompani, por me mbështetjen dhe të bashkive por dhe të AKUM-it, ne kemi dalë nga gjendja e paralizuar nga pikëpamja ekonomike në këto 2 njësi. Po çfarë ka ndodhë? Bëmë ndonjë magji? Jo, s'bëmë magji. I vendosëm dy komponentë mbi baza ligjore, në aspektin e faturimit dhe të arkëtimit, i futëm në sisteme elektronike, duke filluar nga Bashkia Kurbin, Kukës e Shkodër, Të ardhurat e arkëtuara janë në bazë të sistemit elektronik dhe treguesit

vijnë online te shoqëria rajonale Lezhë dhe në vitin 2023. Ujësjellësi Kurbin i ka pasë arkëtimet 156%, në një kohë ku, kur ne e kemi marrë në Shfrytëzim i ka pasë 32%. Për sa i përket ujësjellësit të Laçit, ai ka kaluar nëpër 4 faza, është financuar nga buxheti i shtetit dhe kjo është faza e fundit, që po punohet, dhe mendojmë që në fillimin e muajit maj, qyteti i Laçit do fillojë furnizimin normal me ujë të pijshëm. Për sa i përket impiantit të përpunimit të ujërave të ndotura, ai është ndër katër impiantet e vetme në tërë Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që në angazhimet e qeverisë shqiptare të plotësimit të kushteve për anëtarësim në BE, çdo njësi duhet të ketë impiantin e përpunimit e trajtimit të ujërave të ndotura. Sigurisht që ai për Lezhën është realizuar që në vitin 2004 dhe ka mbaruar rreth vitit 2013, por ka nevojë për ridimensionimin e tij por dhe për përmirësimin e teknologjisë dhe ne do ta marrim në konsideratë me këtë projektin e Bankës Gjermane për Zhvillim për sa i përket përmirësimit të teknologjisë. Kurse ~~pjesa~~ tjetër do të jetë në një fazë të mëvonshme. Përse i përket problemit të ujësjellësit të Shëngjinit, a do ketë probleme sivjet pyet z. Jaku. Shëngjini ka pasë 4500 banorë para 10 vitesh. Sot, fuqia akomoduese shkon 67000 banorë. Ça dua të

them. Ka ndryshuar katërcipërisht. Shëngjini. Ju e shihni vetë se çfarë zhvillimi ka marrë, dhe kështu do kthehet në një turizëm elitar por sigurisht që do të ruhen pasurit e kësaj gjëje. Kapaciteti i lagjes [illegible] aq ka qenë, por pjesa është e drejtë. Por çfarë do të bëhet me lagjen e Shëngjinit. Ne e kemi pasur në vëmendje në veçanti problemin e pyllit të Shëngjinit dhe veçanërisht zonës turistike dhe ka 5 vite që me kryetarin e Bashkisë z. Pjerin Ndreu, i cili ka vendosur dhe vëton për futjen në projektin e Bankës Gjermane për zhvillim të [illegible] të Shëngjinit dhe të [illegible] të Gocaj - Kakarriq. Po pse nuk ndodh natyrshëm kjo punë? Sepse gjithkund ka lobingje dhe kur ndodhi pandemia fondet u tkurrën dhe në shumë bashki u anulluan investimet. Bashkia e Lezhës arriti t'i qëndrojë dhe tani me Bankën Gjermane për zhvillim do bëhet. Shqyrtimi që bëhet me të huaj njëherë, ku sigurisht është vendosur dhe qeveria shqiptare dhe Bashkia e Lezhës, dhe investimi do të jetë vërtet strategjik, dhe do të plotësojë të gjitha kushtet e Bashkimit Europian. Qyteti i Shëngjinit sivjet nuk do ta ketë këtë akses sepse punimet mendohet se do të fillojnë nga fundit të muajit maj ose fillimit të muajit qershor, dhe është faza e parë për pyllin e Shëngjinit. Do të përmirësohet magjistrali kryesor

i ujësjellësit dhe veprat e marrjes së ujit, ndërkohë njëti shpërndarësi do të jetë për një faktë tjetër.
Unë fola për sistemin e kunes per një problem thelbësor është edhe Rëra e Hedhur. sepse dhe atje shikojnë me qindra – mijëra pushues. Megjithëse për të nuk u arrit që të zhvillohej projekti me B.Gj. për Zhvillim, Bashkia Lezhë ke aplikuar me Bankën Europiane për Zhvillim. Ndërkohë që të fitohen këto investime vijnë me konkurim, me performancë. Ne jemi dhe kemi qenë ujësjellësi më i mirë në R.Sh. për sa i përket performancës. Edhe me bashkimin rajonal, jemi fundosur për 6-mujorin e parë, por tani kemi arrit që jemi në targetin e parë. kështu që është një fat shumë i madh dhe për Shëngjinin. Në lidhje me pyetjet e z. Agostin Marku, ky është një ekonomist i vjetër dhe këshilltar i vjetër dhe bën pyetje profesionale. Investimet në proces janë në Nj.A. Shënkoll dhe që nuk kanë përfunduar. dhe operatorët ekonomikë do i çojnë këto ujësjellësa në standarte që janë kërkuar nga projektimi. Pyetja tjetër ishte se sa ndikon bashkimi si shoqëri rajonale – ose e thënë më thjeshtë – a po u bien në qafë konsumatorëve të Bashkisë Lezhë Kurbini e Mirdita – Ato kanë qenë ndërmarrje që nuk kanë marrë rroga 2 vjet. S'kanë paguar sigurime shoqërore kurrë, përgjatë

30 viteve, as tatime. Ne jemi detyruar dhe i kemi financuar pagat e punëtorëve dhe sigurimet shoqërore. Kurse mbas 6 muajve, ujësjellësat kanë hyrë në eficiencë, kanë përmirësuar faturimet, kanë përmirësuar arkëtimet dhe mbulojnë pothuajse 80% koston operative. - Çfarë mori përsipër Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë? - Ata kanë marrë përsipër të na bashkojnë. Në fillim ka pasë probleme por tani situata ka ndryshuar dhe me të drejtë qeveria ka bërë ndërhyrjen. dhe nuk e ka vetëm për Lezhën, por për gjithë Shqipërinë. Detyrimet e prapambetura atje janë. Nuk mendojmë të paguajmë ne detyrimet e Lezhës e Mirditës për një periudhë afatmesme që do ndryshojnë politikat jo vetëm të kompanisë por dhe të qeverisë shqiptare. sepse sigurisht që dhe ata do të na ndihmojnë për shlyerjen e borxheve të prapambetura. Këshilltari Tushaj më pyeti për aktin normativ, për ça fletushka. Problemi është shumë i rëndësishëm për t'u trajtuar. Më 26 dhjetor qeveria ka nxjerrë një akt normativ për përpunimin e ujërave të ndotura, domethënë që çdo subjekt privat që ushtron veprimtari në zonat turistike, do të ngrejë impiantin e ujërave të ndotura personal. dhe për më tepër ka 3 muaj kohë biznesi që të sigurojë impiantin e ujërave të ndotura dhe pastaj do të fillojnë kontrollet përkatëse. Është

Ministria e Infrastrukturës por dhe Ministria e Mjedisit. Ujësjellësi ka rol për dhënien e informacionit në këtë rast. Nuk është pjesë e kontrollit. Sa i përket ujësjellësin të Ungrejt që ngriti këshilltari fitës. (Kolwrazi). Me këtë të drejtën unë nuk e kam dëgjuar. Nëse ky ekziston në kontabilitet të njësisë administrative ose është regjistruar në kontabilitetin e Bashkisë Lezhë, do vihemi në lëvizje.

- Agostin Marku: Z. drejtor, ndoshta fola shpejt por isha dhe dy pyetje, njëra për humbjet teknike 36,76%, a janë të larta dhe si do menaxhohen dhe e dyta ishte për shifrën e lartë që zënë pagat dhe sigurimet në strukturën e shpenzimeve 46,4%.
- Zef Maçi: 36,76% është humbje më e vogël në Republikën e Shqipërisë. 67,8% është mesatarja e humbjeve në shkallë republike. Ujësjellësi i Lezhës ka humbjet më të vogla në gjithë R.Sh. dhe flas me përgjegjësi. Me përmirësimin e furnizimit në zonat rurale, sigurisht që mund të ulet. Për sa i përket numrit të punonjësve, jemi nën efektin e energjisë elektrike dhe kemi 37 rezervuarë uje, kemi 37 stacione pompimi dhe të gjitha këto bëjnë 74, po t'i shumëzojmë me 4 bëjnë shumë më shumë punonjës. Se kështu e ke ligji, duhet me turne, kurse në në fakt kemi 156 në gjithë Lezhën. Po mirë,

po si e bëjmë atëherë? Po shkelim ligjin? Kemi më pak punëtorë. Ne nuk po shkelim ligjin. Jemi munduar dhe kemi bërë kujdes që një punëtor mos ta marrim prej Lezhe e ta çojmë në Dajç për me i dhanë rrogën, por e kemi marrë aty ku ka shtëpinë, aty ku ka rezervuarin.

- Ndue Luli: Z. drejtor, një pyetje fare të shkurtër kisha unë. Cilët janë debitorët më të mëdhenj, ata familjarë apo bizneset?
- Zef Maçi: Duhet të dini që Ujësjellësi i Lezhës nuk ka buxhet. Ne nuk marrim asnjë lek nga buxheti i shtetit, tash 25 vjet, dhe me të ardhurat tona mbahemi. Ne i kemi 100 % arkëtimet. 99,9 % i kemi pasë arkëtimet vitin që shkoi, dhe me këtë balancë të menaxhimit dhe kontrollit të arkëtimeve e mbajmë Shqipërinë. Ka pak debitorë në Lezhë. Njëherë biznes jo, Pra, nuk ka gangrenë.
- Ndue Luli: Të falenderoj.

Fjalën e ka Kryetari i Bashkisë.

- Erdhi këshilltari Edlir Reçi.
- Pjerin Ndreu: Meqënëse bashkë me Zefin kemi qenë nga afër në ndjekje të situatës, problematikës dhe meqënëse jemi në këshill dhe jemi live, le t'i themi ca fjalë, pak fare siç janë.

Seriozitet i Bashkisë Lezhë ka qenë në nivelin maksimal për politikën e ujit. dhe ky zotëria

këtu që pulut Zef Maçi, për Shkak të performancës së lartë që ke pasë në menaxhimin e ujësjellësit, sot është drejtor rajonal dhe ne e kemi nominuar pa marrë parasysh asnjë llaj vlerësimi tjetër, përveçse performancën, sepse ne e kemi marrë seriozisht këtë punë edhe për Leçin, dhe për Mirditën, jo vetëm për Lezhën.
Asnjë projekt ujësjellësi nuk ke pasur në bashki. E kemi filluar me Zejmenin. E kemi bërë ne si bashki, Tale 1, Tale 2, Grykë Lumi. Ujësjellësi i Zejmenit është një histori e cila ka pasë turbulencat e veta edhe për shkak të ngritjes së çmimeve në treg dhe të disa problemeve që ka kaluar shqipëria gjatë kohës e fundit. Nuk kemi paguar akoma lekë. Edhe sot që flasim, kemi detyruar firmën që të bëjë pusin e ri në Tresh dhe cilësia e ujit është analizuar dhe do analizohet përsëri dhe do i marr vetë ato kampionet dhe do i çoj ku të jetë laboratori më i mirë. Kështu që të rrijë i pastër Zejmeni. Kam kërkuar që të vijnë ekspertë nga AKUM-i dhe të verifikojnë pellëmbat për pellëmbat ujësjellësin e Zejmenit. I Tales është duke u bërë.
Dhe e di si kohë ka atje në Tale - E ç'na duhet ne ujësjellësi, kemi ujë boll. Po mo, por e kishe të paçertifikuar. Po nuk vjen turisti ashtu. A e dini ju se sot që po flasim, në

Tale 2 po projektohet një Green Coast i ri. dhe ujësjellësi aty i paraprin një cilësie tjetër. Nuk të vjen keq me ujë pusi ty, dhe ne i kemi paraprirë fëse për bregdetin. Dhe jo rrofshin gjermanët, por rrofshim ne, rroftë qeveria shqiptare sepse është kredi nga KfW gjermane. që vjen investon 16,1 mln euro. dhe zgjidh problemin, atë që kemi thënë, që për shkak të pandemisë u vonua. Sot është tenderi i fundit që zgjidhet firma. Nuk e bëjmë ne. E bëjnë gjermanët. bashkë me AKUM-in. Ne jemi përfituesit. Është e vërtetë ajo që tha Lefi që disa bashkive ua kanë hapë, po mos t'i rrinim te koka, do na hipnin edhe ne. Sa për dijeni. Do bëhet për lagjen Kodërmarlekaj dhe për shkak të harmonizimit të ideve atë me kanë dhënë bonus Gocaj-Kakarriq, KfW-ja, nuk e kishin fare në plan që ta dinë ju, do bëjmë tupizim të plotë të ujësjellësit të Shëngjinit. Për momentin rrjeti i shpërndarjes nuk është në emergjencë por është sasia e ujit që vjen aty. dhe të hënën fillon dhe investimi i rrjetit energjitik të Shëngjinit që komplet nga A-ja te Zh-ja ndryshon. Sot që flasim, me projektin tonë, investohet Ujësjellësi i Dajçit të Zadrimës. Sot që flasim është miratuar financimi për Mërqi-Rraboshtë, që është katastrofë dhe ne adresojmë shumicën e

problemeve kardinale për sa i përket ujit.
dhe vitin tjetër ne do përgatitemi për një tjetër
lëvizje që do trajtojmë disa zona, duke filluar
nga Manatia, Mabe dhe disa pjesë në Shënkoll.
Që të jemi të pastër, e preku pak Zefi, ka
një problem që quhet Rana e Hedhun. Jo
vetëm që s'ka pasë projekt, jo vetëm që s'ka
menduar kush, por s'ka folë askush një fjalë.
Sot që flasim, ne jemi pjesë e një kredie për
i është dhënë qeverisë shqiptare nëpërmjet
FSHZH. prej 7 mln euro, ku Rana e Hedhun
duke filluar nga Porti, Velipojë dhe Malësia e
Madhe janë përfitues. Dhe ne kemi rënë dakord,
në konsultime, jo më larg se para 2 javësh,
me gjithë ekspertët e deleguar për atë punë,
për të adresuar tre probleme në Ranën e Hedhun,
problemin e kanaleve të ujrave të zeza, problemin
e ujit të pijshëm dhe problemi i rrugës për në
Ranën e Hedhun, ku rruga të jetë edhe me
korsi panoramike, edhe me korsi biçikletash
e këmbësorësh dhe kemi rënë dakord. Kaq kishe.
- Ndue Luli: Të gjithë këshilltarët po e shikojnë
se me një informacion që e kemi sipas Planit
Tematik të Këshillit Bashkiak mbledhja zgjati
mbi 1 orë, kështu që ju bëj thirrje për diskutimet
të jeni konciz. Kush e do fjalën për diskutim?
- Alfrida Marku: A mund të sugjeroj diçka për

efjetjen e mbledhjes? Ju keni në rend dite 19 pika. Mirë është që me e redukto edhe pse jo edhe 2 mbledhje në muaj. Mundet të bëhet mbledhje jashtë radhe.

- Ndue Luli: Ne e miratuam rendin e ditës. Mund te thonit kur e hodhëm për miratim. dhe do te merrnim parasysh. kështu që tani do të vazhdojmë, por për diskutimet po ju bëj thirrje, kush ka, shkurtimisht nga 1 minutë kohë secili. Urdhëro z. Ndreu.
- Artan Ndreu: Atëherë përshëndetje. Kisha një pyetje të thjeshtë. A ka një çmim impianti i ujërave të zeza?
- Zef Maçi: Me thënë të drejtën, jo, nuk ka një çmim.
- Ndue Luli: Kush e do fjalën tjetër? Atëherë ju falenderoj të gjithëve
Jemi te problemi i dytë, i cili edhe ky është mbi bazën e tematikës, që është pika 5 e rendit të ditës "Analizë për zbatimin/rishikimin e Planit Social të Bashkisë Lezhë".
Secili nga ne e ka patur materialin më parë, kështu që do te nisim përsëri me pyetjet, meqë drejtoresha e Shërbimit Social në bashki është prezent. Kush e do fjalën? Po znj. Ndoj.
- Donika Ndoj: Mendoj që është një tematikë mjaft e rëndësishme diskutimi i problemeve të

kujdesit social. Me gjithë këto ngjarje që po ndodhin në vendin tonë, në aspektin social, mendoj që kërkon një trajtim shumë të duhur nga këto struktura. Në fakt këta, shumë mirë e keni përshkruar për qytetin funksionimin e saj. Unë mendoj që duhet të krijohen qendra të forta bashkëpunimi në të gjitha njësitë administrative. E parë që për momentin janë 4 nj.a. që jú i keni ngritur këto struktura por duhet në të gjitha njësitë dhe një kërkesë që unë kam, mendoj që të ngrihen qendra nëpër njësi. Çdo nj.a. ka një punonjës social por nuk mendoj që një punonjës social, me popullsi të konsiderueshme për njësi administrative, mund t'i evidentojë, t'i trajtojë këto çështje me atë seriozitetin e duhur. Në këto kushte, kur kemi gjithë këto probleme, vrasje, vetëvrasje, dhunë me bazë gjinore, kemi probleme me fëmijët, adoleshentët të cilët kërkojnë ndihmë të menjëhershme. Nuk mendoj që ata, nga fshatrat e largët mund të vijnë dhe të trajtohen në qytet, ndërkohë që duhet t'u shkojë atje shërbimi. Kjo është krizë alarmante për shoqërinë shqiptare, që po ndesh shumë familje. Ne realitetit po e shohim vetë, në media, se çfarë po ndodh. dhe mendoj që duhet të mirëfunksionojnë këto struktura. Faleminderit.

- Ndue Luli: Radhën tuaj. Ndoj. Pyetje tjetër? Z. Marku.
- Agostin Marku: Para se gjithash dua të them

që është një material shumë serioz dhe është hera e parë që nga gjithë institucionet apo drejtoritë që ne thërrasim, na vjen materiali kaq transparent, kaq shkencor, kaq profesional, çka do të thotë se dhe Bashkia ka në pendër të vëmendjes këtë problem që është një problem delikat në shoqërinë tonë. Unë kam një shqetësim që e bashkoj me shqetësimin e znj. Donika, për sa i përket gjithsej së ngritjes së këtyre njësive në të gjithë njësitë administrative. dhe deri kur dhe çfarë pengese ke, e mbështetje financiare apo çfarë. Për të tjerat jam ok, bravo, vazhdoni që t'i konkretizoni përgjatë vitit. Faleminderit.

- Ndue Luli: Faleminderit. Pyetje tjetër? znj. Marku.
- Alfride Marku: Veç një pyetje. Çfarë ke parashikuar bashkia në lidhje me qendrat sociale për moshën e tretë? kur them qendra sociale nuk nënkuptoj qendra rezidenciale, siç është rasti i projektit që është parashikuar në vitin 2026, mos gaboj, dhe a ka në plan bashkia, që përveç qendrës sociale, jinsfalet mundësojnë nga Krypi i kup dhe jo nga bashkia, të shtrijë këtë shërbim në njësitë e tjera administrative.
- Ndue Luli: Faleminderit. Pyetje tjetër? Po znj. Haxhia.
- Donika Haxhia: Përshëndetje. Edhe unë e lexova me shumë interes. Kemi një koordinator vendor kundër dhunës në familje në Bashkinë Lezhë, Nuk

është emri këtu. Gjithashtu, keni dhe një ekip teknik ndërdisiplinor, që ka marrë disa trajnime. Sa persona ka ky ekip? Dhe këtë pyetje e kam më tepër për të thënë se sa të mundshëm do jenë ata për të marrë një feedback nga komuniteti në lidhje me këto probleme sociale. A është e mundur që të ketë një numër që një vajzë që dhunohet të telefonojë, që të bëhet sa më e mundur lidhja me të. Po punohet nisi gjetjen e një mekanizmi nisi gjetjen e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror. Diçka shumë interesante kjo dhe jam kurioze të di, a funksionon, a ka familje dhe çfarë kriteresh keni, gjithashtu dhe për të dhënë kontributin tonë. Keni bërë disa dëgjesa, nuk e di sa kanë qenë pjesë e miratimit apo të dhënies së ideve të buxhetit për këto. Ju e keni shkruar. Nuk dyshoj. Por a kanë qenë pjesëmarrës, a kanë qenë të mundur të japin mendimet e tyre? Faleminderit.

- Ndue Luli: Pyetje tjetër?

Atëherë fillojmë me përgjigjet e pyetjeve.

Fjala për ju zyj. drejtoreshë.

- Marte Fota: Përshëndetje të gjithëve.

Faleminderit për pyetjet. Siç e tha dhe Apostini, ne jemi munduar që t'jua detajojmë të gjithë analitën e planit social. Plani Social është një dokument strategjik i Bashkisë së Lezhës, për 3-vjeçarin 2023-2025.

Të gjitha pyetjet që ju i ngritët, në fakt janë të shpjeguara. Nëse do flasim për njësinë e vlerësimit të nevojave, duke e parë që ky është një detyrim ligjor, ne e kemi futur te Plani Social dhe Bashkia e Lezhës, në vitin e kaluar, ka punësuar dhe 3 punonjës të rinj, për 3 njësi administrative, siç janë Shëngjini, Shënkolli dhe Balldreni, njësi që e kalojnë numrin e popullsisë, që të kenë më shumë se 2 punonjës sociale. Që të jemi të saktë për të gjithë, në të gjitha nj.a. e kemi administratorin social, i cili është pjesë e stafit të nj.a por është edhe pjesë e Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social. Për të gjitha rastet që ju thatë, njësia e vlerësimit të nevojave është një grup, me jo më një person, që e kemi ngritur në pyetje dhe në 3 njësi administrative. Para një jave ne kemi bërë trajnimin e parë, ku ne kemi rishikuar që do jetë një punonjës i drejtorisë sonë dhe një punonjës i njësisë Blinisht, dhe një punonjës i njësisë Balldre, ku për vlerësimin e situatës social-ekonomike do bëhet një këqyrje në të gjithë zonën, pra kjo njësi nuk do presë që të vijnë individët te njësia administrative, Deri në fund të vitit ne do e kemi të mirëstruar këtë njësi dhe do jua sjellim juve përpara. Të njëjtën gjë pothuajse, pyeti edhe Agostini për njësinë e vlerësimit të nevojave, dokument i cili do ju vijë së shpejti, sapo ne të kemi krijuar të gjitha stafet te nj.adm. dhe nuk është e thënë që në çdo njësi ne do punësojmë

një punonjës të ri, por me punonjësit që ne kemi dhe nën drejtimin e Drejtorisë së Sh. Social, ku çdo punonjës i saj është në kontakt me njësitë administrative për zgjidhjen e çdo çështjeje. T'i marr me radhë pyetjet. Znj. Donika pyeti se si veprojmë, a vijnë rastet te ne apo shkojmë ne te rasti, sidomos për koordinatorin e dhunës. Ne vërtet kemi koordinatorin e dhunës që është i dedikuar në drejtorinë tonë, kemi dhe koordinatorin për barazinë gjinore, pra janë dy profesionistë që punojnë së bashku me të gjithë administratorët socialë që kemi në njësitë administrative. Gjatë gjithë punës sonë, në çdo nj.a. ne kemi minigrupin e tryezës teknike, çka do të thotë: është njësia shëndetësore, është administratori i nj.a, sipas rastit është dhe mësuesja, kemi dhe qendra sociale të cilat nuk administrohen nga ne por janë në bashkëpunim me ne, siç janë qendrat e murgeshave. Të gjitha këto i kemi bërë pjesë të tryezës teknike, si dhe policin e zonës. Përveçse rastet që kanë nevojë për një trajtim më specifik, atëherë tryezën teknike e nga mëngjes koordinatori i dhunës, ku marrin pjesë të gjitha institucionet që janë në territorin e Bashkisë Lezhë dhe kanë detyrimin ligjor t'i përgjigjen koordinatorit të dhunës. Nëse do flasim për pjesën se si i kemi bërë ne dëgjesat publike, pyetje nga znj. Donika, Shërbimi Social bashkë me koordinatorët socialë dhe me të gjithë punonjësit e drejtorisë, sipas target grupeve që ne menaxhojmë,

kemi zgjedhur që të shkojmë në çdo njësi administrative, sidomos për fuqizimin e vajzave dhe grave dhe që them me krenari se pothuajse në çdo nj.a. jemë bërë më shumë se 3-4 trajnime me vajzat dhe gratë nga stafi jonë në bashkëpunim me partnerët tanë, se fatmirësisht, siç e tha dhe kryetari më përpara, ne kemi bërë marrëveshje me shumë organizata lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat ne përgjigjen dhe janë në bashkëpunim me ne për të bërë sensibilizimin që kjo të shkojë te çdo qytetar, çdo vajzë, grua, djalë apo burrë sepse të gjithë jemi të rrezikuar nga dhuna në familje. Dhe së fundmi Bashkia Kelthi ka bërë marrëveshjen për të mitur në konflikt me ligjin. Kemi krijuar tryezën e madhe me të gjithë drejtuesit rajonalë. Këtë po e zgjerojmë dhe po e çojmë në çdo njësi administrative ku kemi të përfshirë aktorë që që thashë më përpara, kemi fituar 3 projekte si bashki dhe së fundmi Qendra komunitare "Fuqizojmë Komunitetin", ku kemi startuar një sërë shërbimesh dhe përveç pjesës së dhunës në familje, ne kemi futur dhe personat me aftësi të kufizuar mbi 21 vjeç, të cilët i kishim të pambuluar si shërbim nga Qendra e Zhvillimit Ditor apo nga projekti social që kemi fituar në ministri dhe jemi në vitin e pestë që e ka futur bashkia në strukturën e Shërbimit Social.

- Doli z. Pjetër Noka.

- Marte Seta: Sa persona kanë marrë trajnim ishte një pyetje. Në fakt ne jemi gjithmonë në vazhdimësi të trajnimit të stafit tonë por stafi jonë tashmë është i trajnuar për të trajnuar të gjithë personat që janë pjesë e tryezave teknike të mekanizmit kundër dhunës në familje, gjithashtu dy punëtorët që ne kemi për mugjin kundër trafikimit të personave dhe për dhunën në familje. Ne në fakt nuk ndalemi dhe mund ta themi me krenari që brenda një viti ne mund të trajnojmë deri në 200 vajza, gra, djem dhe burra, veçanërisht ne jemi të kushtuar te vajzat dhe grate të cilat mund të jenë më të përpirva dhe më në situatë dhune në familje. Dhe pyetje se si shkon informacioni te gratë e dhunuara dhe si mund të kërkojnë ato ndihmë te ne, në fakt në të gjitha njësitë adm. ku ne bëjmë takimet me qytetarët, ne i informojmë adresën se ku mund të drejtohen, nëse dëshirojnë ato. Kemi bërë trajnime me gjithë qendrat shëndetësore sepse e kanë dhe ato nevojë, në momentin që u paraqitet një vajzë apo një grua, të informojnë koordinatorin e dhunës. Është dhe një numër telefoni falas në Tiranë dhe në çdo trajnim ne ua bëjmë të ditur. Për familjet kujdestare ishte pyetje tjetër, në fakt kjo është një gjë shumë interesante. Ky ka qenë një detyrim

ligjor nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por fatkeqësisht nuk ka funksionuar. Ne kemi familje kujdestare, ku pranë Shërbimit Social afrohen vetëm familjet e gjakut. dhe ne e kemi vënë te Plani Social sepse dëshira është që ne të kemi përtej lidhjeve të gjakut. Kujdestaria është deri 18 vjeç. Nuk është se ti e birëson përfundimisht por e merr në kujdestari për ta ndihmuar për t'u mirërritur. Deri tani jemi në diskutim që të hapim një thirrje që pranë Sh. Social të regjistrohen familje për këtë qëllim, që nuk kanë lidhje gjaku. Kur kemi pasë raste, u kemi bërë thirrje fillimisht familjeve të gjakut. Në rastet kur nuk na janë përgjigjur, kemi pasë raste ku i kemi sistemuar në qendra rezidenciale. Faleminderit Alfrida për pyetjen. Ti duhet ta dish që mosha e tretë nuk është vetëm në menaxhim të Kryqit të Kuq. Është në menaxhim edhe të bashkisë. Sepse është një marrëveshje mes nesh. Ne kemi godinën, paguajmë ujë, drita e të gjitha. Është i dyti vit që ne i sponsorizojmë me një koordinator. Në fakt qendrat e moshës së tretë po i diskutojmë edhe në njësitë administrative sepse kemi bërë një studim dhe jemi në vetëdijësim të këtij se sa të moshuar janë por nëpër njësi të moshuarit nuk e kanë shumë dëshirën që të bashkohen nëpër qendra, qoftë edhe ditore. Dhe së fundmi ne kemi aplikuar edhe për një projekt që t'ia çojmë shërbimin

në banesë. Sepse strategjia e ministrisë përputhet me konventat europiane. Gjithashtu dhe me iniciativën e kryetarit, ne po bëjmë një studim që t'u mundësojmë të moshuarve lehtësi për udhëtimin nga pendrat rurale në pendrat urbane.

- Ndue Luli: Kush e do fjalën për diskutime?

N.q.s nuk ka, faleminderit ju dhe drejtoreshës për informacionin.

Tani kalojmë te projekt-vendimet. Duo të përshëndes të gjithë ato komisione që janë mbledhur për të diskutuar lidhur me projekt vendimet e sotme, gjë që tregon për korrektësinë, për vullnetin që kanë këshilltarët, duke bërë më të lehtë punën dhe të mbledhjes së këshillit, por dua të tërheq vëmendjen e disa anëtarëve të cilët akoma vazhdojnë të kenë mungesa në mbledhjet e komisioneve. Do një rast që do bëjmë analizën 1-vjeçare të punës së këshillit, që do u përmendim dhe emrat se sa kanë marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve.

Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Janar 2024".

Kush është dakord me p/vendimin?

Miratohet me 30 vota PRO. Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.

Kalojmë te projekt vendimi "Për një shtesë në VKB nr. 70, dt. 14.12.2023 "Për miratimin e PBA-së 2024-2026 dhe Buxhetit të vitit 2024" dhe përdorimin e fondeve të trashëguara nga viti 2023".
Duke qenë se problemet e buxhetit janë të shumta sot dhe mbledhja e komisionit të Financës ka funksionuar, fjalën e ka kryetari i Komisionit.
- (Ky është p/vendimi në pikën 8 të rendit të ditës por meqë kryetari e lexoi, u ra dakord që të kalojë, pastaj të rikthehet me pikën 7)
- Erdhi (u kthye) këshilltari Pjetër Noka.
- Agostin Marku: Komisioni i Financës është mbledhur, ka shqyrtuar një sërë projekt vendimesh. Ky p/vendim vjen si domosdoshmëri nga akt rakordimet e bashkisë me Thesarin për të gjitha tepricat e vitit të kaluar, që siç e dimë trashëgohen dhe këto fonde, bashkia ka menduar që t'ia shtojë, si në të ardhura ashtu dhe në shpenzime buxhetit të bashkisë për vitin 2024. Ne e shohim me vend si komision dhe ftoj këshillin që ta miratojmë.
- Kolec Luli: ka ndonjë pyetje? Po zoj. Marku.
- Alfride Marku: Kam një pyetje: ~~kemi të bëjmë me 2 mld lekë të vjetra~~, pse kanë statusin e fondeve të trashëguara dhe pse nuk janë përdorur në vitin që lamë pas?
- Brikena Vuksani (D. Financës): Ka transferta të pakushtëzuar nga të ardhurat vendore dhe nga transfertat sektoriale.

dhe për të tjijë këto ka tepricë nga fondet. E para është për pagat sepse nuk ka pasë strukturën e plotë pastaj pjesa tjetër sepse te transferta sektoriale ka pasë numrin më të madh për punonjësit dhe nuk ka qenë struktura e plotë dhe nga fondi i shtetit janë marrë më tepër fonde. Ndërsa për të tjerat ka qenë sepse nuk janë realizuar - keni pasë kontratat e lidhura të shpenzimeve, me afat 1-vjeçar dhe nuk janë ezauruar deri në fund të vitit. këto kalojnë në buxhetin e vitit 2024.

- Flutura Gjoni: Pra këto janë kontrata të lidhura?
- Brikena Vuksani: Po, janë kontrata të lidhura, të gjitha tepricat shkojnë për detyrimet e prapambetura që ka bashkia.
- Flutura Gjoni: Nëse janë kontrata të lidhura, pse duhet të shtohen tani dhe nuk u miratuan në buxhetin që miratuam? Pse nuk u parashikuan? Dhe bëjmë shtesë kaq shpejt?
- Brikena Vuksani: Kjo është me udhëzim të M.F. që tepricat që ngelen nga fondet e papërdorura gjatë vitit duhet të shkojnë patjetër te kontratat që janë të lidhura dhe detyrimet që kemi ne për to. Nuk janë realizuar shpenzimet deri në fund të vitit. Buxheti është mbyllur në nëntor dhe nuk ka qenë e mundur që të planifikohen deri në nëntor këto.
- Pjerin Ndreu: A t'ju shpjegoj unë cilat pse

unë nuk jam ekonomist. Buxheti miratohet në fund të nëntorit, ose kur e bëmë në në mes të dhjetorit dhe ne do presim datën 31, për subjektet, ke plot që nuk kanë paraqitur faturat, për të likujduar dhe kalon data 31 dhjetor dhe normalisht këto fonde që ne i prisnim deri në fund, mund të kalojnë për më vonë. Ose është kontrata e shërbimeve p.sh., që është lidhur diku nga gushti e shtatori sepse atëherë ka mbaruar prokurimi dhe ajo ka afat zbatimi 1 vit. Me ato që ka sjellë, ne nuk mund t'i cë likujdonim të gjithë por kalon në vitin tjetër, sepse ne duhet të presim datën 31 çfarë ndodh. Dhe është kjo diskordancë që natyrshëm çdo vit ka ndodhur.

- Agostin Marku: Pra, për të sqaruar këshillin, të gjitha ato të cilat ishin parashikuar në buxhetin e vitit 2023, por për arsye të ≠ të afateve ligjore, tenderimeve, mosparaqitjes së situacioneve nga kompani të ≠ që kanë lidhur kontratë me bashkinë, nuk janë shpenzuar deri në fundin e vitit dhe nuk mund të parashikoheshin në buxhet sepse buxheti ka filluar herët sipas fazave që ka. Si rezultat i kësaj, është bërë rakordimi në Degën e Thesarit bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave. Dhe ne po bëjmë një sistemim në vendimin

përkatës për buxhetin.
- Ndue Luli: kush ka ndonjë diskutim tjetër? Atëherë meqë nuk ka, kush është dakord me projekt vendimin?
Miratohet me 26 vote PRO.
Nuk votuan këshilltarët Aleksandër Mekaj, Alfride Marku, Emanuel Pinjaku, Flutura Gjoni.
Abstenuan këshilltarët Donika Ndoj, Donika Haxhiu.
Tani jemi te projekt vendimi në pikën 7 të rendit të ditës. "Për një shtesë në VKB nr. 70, dt. 14.12.2023 "Për miratimin e PBA-së 2024-2026 dhe Buxhetit të vitit 2024" dhe përdorimin e fondeve të trashëguara të tërmetit nga viti 2023"
Fjala për kryetarin e komisionit.
- Agostin Marku: Është e njëjta procedurë si shqyrtimi për sapo miratuam. Është bërë e veçantë edhe në kuadrin e transparencës së bashkisë me publikun, me këshillit dhe të gjitha institucionet për fondet e trashëguara për kanë ardhur me destinacion tërmetin, të jenë në vendin të veçantë, duke i planifikuar edhe për këtë vit të gjitha ato tepricë vetëm në ato destinacion në të cilin kanë ardhë.
- Ndue Luli: Pyetje? Po znj. Marku.
- Alfride Marku: Pse këto fonde, 2 mld lekë afërsisht, nuk janë përdorur në vitin 2023, për se kohë janë të adresuara nga buxheti i shtetit për një çështje shumë problematike, rindërtimi përfund-

dimtare e pasojave të tërmetit. Me këto fonde, a zgjidhen dhe rehabilitohen përfundimisht të gjitha pasojat e tërmetit, thënë ndryshe, a i jepet fund ndërhyrjeve me efekt rikonstruksion, rehabilitim të banesave individuale apo godinave në bashkëpronësi si dhe institucioneve publike sepse përveç objekteve në pronësi të individëve ka patur pasojë dhe te institucionet publike. A i jepet zgjidhje përfundimtare me këto 2 mld lekë rindërtimit të afërsisht 41 banesave individuale në njësitë administrative dhe rindërtimit të pallatit në pendet të qytetit, tek ura në hyrje të qytetit të Lezhës, në të cilin kanë penel afërsisht, mos gaboj, 12 familje dhe ende nuk kanë zgjidhje. Edhe diçka tjetër, në pikën 2.2. thuhet punime ndërtimi për objektin rindërtim i urës së Zezë mbi lumin Drin - mua më nga kjo kam për kam përshtypjen, jam e bindur që kjo emërtesë ka dukshëm konotacion diskriminues, të papëlqimshëm por mië është që të korrigjohet. Kaq kisha.

- Ndue Lleshi: Pyetje tjetër ka?

Atëherë le të vazhdojmë me përgjigjen.

- Brikena Vuksani: Ka një dhe rekordin bashkë-ngjitur p/vendimin dhe e shikoni se secili vendim i Këshillit të Ministrave, ka teprice për secilin, kjo në radhë të parë një për

shkak të lidhjes së kontratave. Janë lidhur me vlerë më të ulët nga ç'është akorduar VKM. Tepricat kanë ngelur atje jo vetëm për vitin 2023 por edhe për vitet më përpara. Nga Ministria e Financave nuk ka akoma asnjë udhëzim se si do procedohet që këto të tërhiqen mbrapsht. Ndërsa pjesën më të madhe të këtyre fondeve, po të shikoni, janë te nr. 16, 17, 18 që është për financimin e rindërtimit të banesave, këto janë për DS4, DS5 dhe janë për familjet që nuk kanë marrë akoma këstin e dytë për procedurat e dhënies së lejes nga Drejtoria e Urbanistikës.

- Ermal Paçaj: këto nga Programi i Rindërtimit janë për zëra të caktuar. E theksoi dhe drejtoresha e Financës, këto lekë janë gjëndje në arkën e bashkisë, por janë për 40%-shat të cilat nga 197 familje, rreth 45% e tyre akoma nuk e kanë tërhequr pjesën e dytë të grandit, për shkak të mospërputhjes me lejet e ndërtimit apo për shkak të moszgjidhjes prane Bashkisë së Lezhës, Zyrës së Urbanistikës, pjesën dokumentare për ta tërhequr këtë fond. Të gjitha fondet për pjesën e rindërtimit, qeveria shqiptare i ka financuar, e theksoj për të disatën mbledhje se problemi i vetëm që ka sot Bashkia Lezhë për rindërtimin

n.p.s duam ta pyejmë problem, është ndërtimi i 40 shtëpive individuale të ulët fond financiar edhe ato nga qeveria shqiptare por fond financiar për t'u ndërtuar, por shkak të problematikës së çmimeve, këto banorë, 33% e tyre kanë bërë kërkesë për të tërhequr fondin për ta ndërtuar vetë shtëpinë e tyre dhe ne kemi bërë kërkesën për të ndryshohet VKM-ja dhe pallati i ish BKT po e kemi diskutuar dhe herën tjetër për ngërçin që u krijua për arsye të marrëveshjes që kishim më përpara. Sa i përket pjesës së emërtimit të urës së Zezë, po, aty është një problematikë, se kur është bërë verifikimi nga Instituti i Ndërtimit, atje ura nuk është se kishte një emërtim, e vendosën ura e Zezë, ishte thjesht diçka teknike.

- Pjerin Ndreu: Dhe një spanim për të jemi të parti. Nuk adresohen të gjitha problemet e tërmetit. Ne dy probleme kemi pa zgjidhur: problemi i pallatit këtu që do e zgjidhim dhe 40 shtëpi individuale që ne e kemi marrë fondin por pasi është prokuruar është tërhequr firma për shkak të rritjes së çmimeve në treg. Kemi bërë disa kërkesa, nuk na është hapur akoma atje për të shtohet çmimi, sepse kjo ka qenë pasojë për gjithë Shqipërinë dhe

nuk e di si do adresohet por në mënyrë që me qeverinë mund të bëhet që bashkërisht të tërheqim lekët dhe të bëjmë votë zgjidhjen. Mendoj se brenda këtij viti ne do i gjejmë rrugë. Kryeministri do jetë të dielën këtu dhe unë do e bisedoj personalisht për këtë çështje. E kam biseduar disa herë në takat por tani na takon që t'i gjejmë zgjidhje.

- Ndue Luli: Atëherë kush është dakord për kalimin e p/vendimit?

Miratohet me 31 vota PRO.

Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.

Kalojmë te pika 9 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e ndihmës financiare për z. M. Gj. nga fondi i emergjencës".

Fjala për kryetarin e komisionit z. Noka.

- Gjetër Noka: Ne jemi mbledhur dje dhe e kemi parë të argumentuar që ta kalojmë.
- Ndue Luli: Kush është dakord për kalimin e projektvendimit?

Miratohet me 31 vota PRO.

Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.

Vazhdojmë me pikën 10 të rendit të ditës që është projekt vendim "Për trajtimin me bursë të nxënësve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2023-2024".

Siç e kemi parë dhe në p/vendim, bëhet fjalë

për një bursë të plotë dhe një gjysmë burse.
Është pozitiv fakti sepse janë të drejta studimi.
Po pati diçka mirë, përndryshe unë jam bëj
thirrje për votimin. Kush është dakord?
Miratohet me 31 vota PRO.
Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.
Kalojmë te pika 11 që është projekt vendim "Për
miratimin e Programit të Transparencës për Bashkinë
Lezhë".
Në lidhje me këtë p/vendim fjalën e ka z. Ndreca
- Esin Ndreca: Komisioni i Urbanistikës, Programeve
të Zhvillimit dhe Integrimit, në lidhje me këtë
projekt vendim, u mblodh, e shqyrtoi, në prani të
drejtorit z. Elson, të cilin e falenderojmë për
pjesëmarrjen. U vu re që më transparente se kaq,
nuk besoj se mund të ketë. Informacionin për
transparencën e keni në lidhje me organizimin e
bashkisë, me llogaridhënien ekonomiko-financiare,
me kërkesat për informim, me shërbimet që ofron
bashkia, legjislacionin. Na u vu në dispozicion
një raport i monitorimit të zbatimit të detyrimeve ligjore të sigurisë
dhe transparencës të procesit të konsultimit publik
nga Faktoje.al, që është një agjenci shumë prestigjioze,
e cila monitoron transparencën e bashkive, vihet re
që dhe indeksi i transparencës së Bashkisë Lezhë
është në masën 100%, siç e kanë bashkitë
Shkodër dhe Korçë. Atëherë më transparente se

kap, nuk mund të jetë i ndaj ne të flojnë që të kalojmë këtë projekt vendim.

- Ndue Luli: Mepo kryetari i komisionit dhe mendimet në lidhje me këtë p/vendim, në emër të Komisionit, kush është dakord me projekt vendimin?

Miratohet me 30 vota PRO.

Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.

Këshilltari Emanuel Përjaku votoi KUNDËR.

Vazhdojmë me pikën 12 që është projekt vendim "Për miratimin e prioriteteve dhe projekteve për investime në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025"

Fjala për kryetarin e komisionit të financës.

- Agostin Marku: Për këtë pikë do flasë zv/kryetarja e komisionit znj. Flutura, prioritetet, kështu e lamë dje në komision.

- Flutura Gjoni: Unë isha dakord. Kisha vetëm dy pike. Kisha një shqetësim pyetje për pastrimin e Drinit, që të futet edhe kjo në prioritete. Ato rrugët, është e përsëritur kërkesa, të na detajohen, që të dimë, kur të ngremë dorën për këto rrugë, të mendojmë, a është me të vërtetë prioritet ajo rrugë, pra janë rrug rrugë rurale, rrugë urbane. Kaq kisha.

- Donika Hoxhia: Të njëjtën gjë që tha Flutura e kam edhe unë për rrugët. Rehabilitim i rrugëve rurale është me dendësi popullsie. Ndoshta del

pak nga kjo, po a ka ndonjë informacion bashkia për numrin e popullsisë, meqë censusi i organizuar së fundmi nuk na është bërë publik? Dhe diçka, kryetari i bashkisë në një nga mbledhjet e kaluara e tha për ndërtimin e qendrës së penve endacakë nuk do të jetë me fondet e bashkisë por do të jetë një dhuratë, më duket do kend harruar dhe e kend futur prapë këtu.

- Donika Ndoj: Te periudha e financimit 2025, 2026, 2027, nuk e kuptoj, është zero.
- Agostin Marku: Donike, shiko fletën tjetër.
- Donika Ndoj: ok, ndoshta nuk e kam kuptuar unë.
- Donika Hayhia: E kishe për shkollat. Rikonstruksion shkollat, dmth të dimë cila shkollë është, sepse mirëmbajtje është fjalë tjetër, fjala rikonstruksion ka peshë pak më të madhe.
- Alfrida Marku: Është e njëjta histori, sikurse me planifikimin afatmesëm për kushtim para disa muajve. A ka një plan konkret bashkia, ose sa pjesë të buxhetit zë, nëse zë, ndërhyrjet për rehabilitimin e infrastrukturës vaditëse dhe kulluese në tokat bujqësore të Bashkisë Lezhë. Mos gabohi, në Lezhë janë 18000 ha. sipërfaqe tokë bujqësore dhe jo më shumë se 25-30 % e tyre. A ka plan bashkia për të ndërhyrë në infrastrukturën vaditëse dhe kulluese në tokat bujqësore. A ka plan bashkia për të

zgjeruar zonën urbane, i referohen qytetit të Lezhës, gjatë dy lagje, sidomos lagjja Skënderbeg një gërmadhë por të këtij mundësinë për ta rikualifikuar dhe zgjeruar në mënyrë të jashtëzakonshme qytetit e Lezhës. Lagjet Gurra dhe e Spitalit në gjendje të mjerueshme me infrastrukturën bazë, rrugë, ujërat e ndotura, ujërat e shiut, a ke mundësi për bashkia të kete një plan konkret, paftë dhe në 4-vjeçar për ta zgjeruar në parametra bashkëkohorë qytetin e Lezhës. A ke në plan bashkia ndërtimin e një parku, ku i referohen gjelbërimit. Të njëjtën e parapamë edhe në këtë projekt - Ju parashikoni rehabilitim në rrugë urbane e rurale, por për arsye që dihet sepse bëhet, për t'i hapë rrugë abuzimeve dhe këtë e them pa mëdyshje, ju akoma nuk jeni në gjendje të specifikoni se në cilat rrugë konkretisht, bashkia parashikon të ndërhyjë. E thotë këtu me të madhe, bëtë lajme të paguara në media kombëtare, ku mundët e ku s'mundët në dhjetor e në janar, sikur bashkia kishte buxhetin më të madh të kushtoli se Kakarronë dhe 5 mld lekë ishin adresuar, vetëm në infrastrukturën rrugore. Me shumicë që e keni firmosë vetë keni përgjigje që nuk na penkon 5 mld lekë por janë rreth 310 mln lekë në rrugë

urbane dhe 2 mld lekë në rrugë rurale.
Meqë jeni këtu prezent z. Kryetar i Bashkisë,
a mund të kemi informacion ne si këshilltarë
se në cilat rrugë konkretisht urbane dhe
rurale po ndërhyn Bashkia Lezhë për rehabi-
litimin e tyre, meqë këtu në shkresën tuaj keni
referuar projekte në vazhdim dhe në cilat
planifikon rishtas Bashkia Lezhë që të
ndërhyjë për rehabilitimin e tyre, që të dimë
edhe ne se ku kanë shkuar këto 5 mld lekë
që vijnë nga taksat e lezhjanëve.
A ka një plan Bashkia Lezhë për rehabilitimin
e qendrave të njësive administrative, për ndri-
çimin e rrugëve rurale, të cilat për shkak
të mungesës së ndriçimit përbëjnë shkak për
aksidente rrugore, për të mos t'i hyrë dhe
veprave të tjera penale si vjedhje etj.
E theksoj dhe kur paraqitët Planin Social,
a ka një plan konkret për të ngritur një qendër
sociale të thjeshtë, ku mosha e tretë nëpër
çdo qendër të nj. adm. të mblidhet dhe të
pijë një kafe aty apo të luajnë domino.
Gjithashtu, te prioritetet që keni paraqitur
këtu, ka disbalancë mes prioriteteve dhe
shumave buxhetore. Si ka mundësi që për
një qendër për qentë endacakë ju dedikoni
500 mln lekë dhe si ka mundësi që ne

kushtoka më pak, por ke më pak rëndësi për ju, qendra e zhvillimit ditor ku marrin shërbim rreth 50 të rinj me aftësi ndryshe si dhe qendra rezidenciale për moshën e tretë, respektivisht 200 mln dhe 230 mln.

- Pjerin Ndreu: Shqyrtova zotit që flet dhe tregon që nuk ke haber nga buxheti fare. Ke hyrë e ke dalë prej aty dhe s'e ke idenë se nuk di me lexu. Aty janë të ndara. 5 mld shkojnë për rrugë dhe një pjesë janë për likujdimin e disave që janë bërë. E dyta 3 pikë se që the, janë llogaritur për sivjet. E treta, shumë shpejt ne po përfundojmë projektet e rrugëve. Ne kemi bërë një përcaktim paraprak, por po shikojmë nëse kjo shumë na i mbulon të gjitha ato që kemi planifiku apo jo. Sepse kur t'jua japim, do jua japim me milimetra ato rrugë. Nuk jepen si thua ti, sot për nesër, sepse nuk jemi duke bërë kërcim 3 hapësh. Jemi duke bërë një studim të thelluar. Për sa të jem unë kryetar bashkie, 60% e buxhetit do shkojë në zonat rurale se zotrote me bashkinë tënde s'ke bërë asnjë gjë.

Të fillojmë me lumin. Lumin e administron Bordi i Kullimit, jo bashkia, kështu që ne nuk mund të planifikojmë. Disa pyetjeve do u përgjigjet Elsoni, jo zona urbane, jo rurale. Për të transformuar

një pytet duhet të hipen eto për thamë, duhet të hipen ujërat e zeza dhe ujërat e Shibët adresohen tani dhe me tu adresuar vijnë me radhë.
Sado të lodhesh ti, nuk bëhesh e besueshme sepse ke pená aty. dhe ujën e tregon këtu se nuk ke kuptuar asgjë. Na dole dhe në Lag. Park të gjelbëruar thotë. Po, kemi planitu park të gjelbëruar. Ne kemi rikualifikuar këtë lulishten përballë. E kemi ndryshuar komplet, me infopoint, me të gjitha. Po bëjmë parkun "Dua të luaj". Është plani i një parku të gjelbëruar kryesisht, te stadiumi, me parking. Kemi futur një studio arkitektësh të na bëjë të gjitha parqet e gjelbëruara të Lezhës, të rikualifikohen, të shikohen një për një, në Lezhë dhe Shëngjin si fillim por dhe në gjithë njësitë e tjera. Ndriçimi publik ka pená dramë në mes të pytetit. Në pytet dhe në Shëngjin çdo ne kemi ndriçim LED dhe është super i ndriçuar pyteti. Kemi ndriçuar dhe rrugën e Kolosë, kemi ndriçuar shumë rrugë rurale, kemi ndriçuar rrugën e Ishullit, është ndriçuar lagjja e Shelqetës, është ndriçuar rruga e Shëngjinit me këmbëngulje time me ARRSH-në, kemi ndriçuar rrugën për te Mrizi i Zanave, rrugën nga Shinat te SMT-ja që del për te rruga kryesore në autostradë. Kemi fituar një projekt 400 mln tani për

ndriçimin rural, kemi ndriçuar Grashin, Dajçin në fendet. Kjo puna e penve, me thënë të drejtën, është e vetmja që ju ka ngelur në gojë. U kanë herë e parë hipeni, si duket s'paska reflektuar. 500 mln për pentë s'kanë për të shkuar ndonjëherë. Megjithëse ne pajuajmë për sterilizimin e penve, ka tre vjet që e bëjmë këtë, por një fendet ne është afruar. Kjo 500 milionshi do ndryshohet normalisht. E kalojmë në mbledhjen tjetër.

- Ndue Luli: Faleminderit. z. Marku.

- Agostin Marku: Vetëm një sqarim që ta shkurtojmë pak këtë problem sepse realisht ne nuk po miratojmë buxhetin e bashkisë sot me këto shifra. Ne po flasim për prioritetet 2025-2027. Që këto projekte sipas strategjive edhe ndryshojnë, Np.s ne si këshill bashkie, do flasë edhe kryetari i Komisionit të Urbanistikës pastaj, sepse është shqyrtuar dhe aty, e shohim të arsyeshme edhe nga reagimet e komunitetit por edhe e njohim situatën dhe kemi një objekt tjetër prioritar që nuk është i shkruar këtu, kujdes ta propozojmë, vetëm mirë bëjmë" sepse me këtë do vëmë në punë dhe drejtoritë përkatëse që të përgatisin projektet, që këto projekte edhe t'i dërgojmë në institucione të ndryshme financiare, që të thithen edhe sa më shumë fonde. Nuk po miratojmë buxhet sot. Ne po miratojmë

prioritete që i paraprijnë edhe treguesve të buxhetit edhe të PBA-së që ne ndërtojmë për në të ardhmen. Kaq e kisha sa për sqarim. Faleminderit.

- Ndue Luli: Fjala për z. Ndreca

- Erin Ndreca: Atëherë, e njëjta gjë, pavarësisht se i priu z. Agostin. Në fakt është mirë që t'u jepet fjala komisioneve që të eleminojmë zgjatjet. Ne e shqyrtuam projekt vendimin dhe në këtë proces, Drejtoria e Projekteve Strategjike, duke iu drejtuar të gjitha drejtorive në bashki në lidhje me parashikimet e investimeve për vitin 2027, në kuadër të PBA-së 2025-2027 dhe duke u mbështetur në dokumentat strategjikë të nevojave, sipas fushave përkatëse për secilën drejtori, janë sjellë prioritetet në këtë drejtori. Çfarë dua të them me këtë. Me sa di unë, bashkia është një institucion shërbimesh, i shumëanshëm dhe i ankesave. Nuk mendoj se secili nga ne të ketë ankesa apo të ketë informacion më shumë se drejtoritë përkatëse të bashkisë, të cilat kanë paraqitur prioritetet në lidhje me nevojat e komunitetit. A ka nevojë për më tepër? Patjetër që ka, por nuk mund të hidhen poshtë këto. Po të shikojmë p.sh. ndërtimi i zjarrfikëses në Lezhë, ndërtimi i terminalit të autobuzave, e me radhë të gjitha, janë projekte të cilat kanë interes publik më të madh se sa ndërtimi mbase i një parku, i cili, nuk e mohoj që mund të jetë i nevojshëm, kur

ekziston një, prandaj këtë, mendoj që e vlerëson më mirë bashkia dhe drejtoritë përkatëse të cilët kanë specialistë përkatës dhe nuk është që të rrijmë këtu dhe të përsërisim herë pas here të njëjtat gjëra, thjesht për të thënë se i thamë dhe të bëjmë zhurmë e të humbim kohë. Ne posi i shqyrtuam, posi na bëri të parët drejtori, mendojmë që çdo gjë është ok dhe ta kalojmë në votim, pastaj nëse ka gjëra për të shtuar, ok.

- Ndue Luli: Faleminderit z. Ndreca.

Fjala është për z. Frroku, drejtor i Projekteve Strategjike.

- Elson Frroku: Duke falenderuar folësit e fundit që në fakt ishin shterues sa i përket thelbit të projektvendimit, sa i përket atyre diskutimeve që u bënë, i sqaroi kryetari i Bashkisë për vizionin e bashkisë. Në fakt këto janë prioritetet për investime të vitit 2027. Ligji i financave dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave detyrojnë bashkinë që të parashikojë një vit në avancë dhe e marrë në konsideratë kjo, duke iu referuar udhëzimit, siç e citoi dhe parafolësi im, këto prioritete nuk kanë dalë nga hiçi, por kanë dalë nga dokumentet strategjike të bashkisë dhe nga vizioni që kanë secila nga drejtoritë përkatëse. Faleminderit.

- Ndue Luli: Faleminderit ju. Fjala për z. Përgjoka.

- Emanuel Përgjoka: Një çështje sensitive, e cila është bërë publike dhe ka disa kohë që zvarritet është

kompozimi dhe vendosja e shtatores së Skënderbeut.
Ideja është që, pse nuk është vënë prioritet në vitin 2025 p.sh., se sa më afër, aq më mirë, sepse disa tentativa për ta shpallur 2 Marsin festë kombëtare ka pasur.

- Ndue Luli: E parta. Ka ndonjë sqarim të shkurtër e konçiz për këtë?

- Pjerin Ndreu: Është një problem, që jemi të gjithë dakord. Na doli një problem shumë i çuditshëm, s'janë paguar lekët. Dmth është porositur shtatorja, janë 70 mln lekë të vjetra, nuk janë paguar. Ne nuk kishim mundësi me buxhetin tonë. Që të jem i qartë, unë kërkova të vihet aty ku do vihej herën e parë, nuk na lanë, atëherë u dakordësuam për një vend tjetër, e takova dhe skulptorin vetë. Ai tha "e sjell, po lekët ku janë?" Kanë bërë gjithë atë gurgule, e nuk kanë paguar as lekët, as leje nuk kanë dhënë vetë, as kërkesë për të marrë miratim, asgjë fare. Kështu që në këto kushte, ne do ta vëmë atë shtatore, pasi besoj se me buxhetin tjetër, jo këtë, sepse ky buxheti tani është që ne do dalim në nivelin zero me borxhet.

- Ndue Luli: Faleminderit
Kush është dakord me projekt vendimin?
Miratohet me 26 vota PRO.
Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.

Këshilltarja Donike Ndoj abstenoi.
Këshilltarët Donike Hoxhia, Flutura Gjoni, Gjovalina Zefi, Alfride Marku ishin KUNDËR.
Kalojmë te pika 13 që është projekt vendim "Për përfshirjen në prioritetet e vitit 2024 "ndërtimin e ujësjellësit për furnizimin me ujë të pijshëm të fshatrave Mërqi dhe Rraboshtë""
Fjala për kryetarin e komisionit.
- Agostin Marku; ky p/vendim ka të bëjë me atë që e theksuam dhe në p/vendimin tjetër, me prioritetet mund të ndryshojnë. Jo ku u krijua mundësia të gjenden fonde, të parashikohet dhe ujin për vendimmarrje në këshillin e Bashkisë, në rast ku të akordohen fondet, ujin dhe shtese në buxhet. Pra, strategjitë ndryshojnë sipas strategjive, sipas emergjencave, sipas sigurimit të fondeve etj. Faleminderit.
- Ndue Luli; Faleminderit
Kush është dakord me projekt vendimin?
. Miratohet me 31 vota PRO.
Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.
- Largohet këshilltari Edlir Reçi
- Ndue Luli; Kalojmë te pika 14 që është projekt vendim "Për dhënien e dakordësisë për ndjekjen e procedurave, për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqes

së fondit pyjor në pronësi të Bashkisë Lezhë, për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për pyjet".
Fjala për kryetarin e Komisionit z. Jaku.

- Dod Jaku: Përshëndetje të gjithëve
Komisioni i Bujqësisë mbasi e mori në shqyrtim këtë projekt vendim, duke parë materialet e paraqitura nga Drejtoria e Bujqësisë, bëhet fjalë për një sipërfaqe prej 8 ha për dhënien e dakordësisë nga ana jonë si Këshill Bashkiak. Kjo sipërfaqe jepet me qera. Është pronë e Bashkisë Lezhë, kryesisht për zhvillimin e energjisë së rinovueshme. Ka shprehë interesin një firmë private, aty mund të jenë konkurente pastaj shumë firma të tjera. Pra duke parë se nuk krijohen probleme sepse është pronë e bashkisë dhe probleme me ekosistemin nuk krijojmë sepse bëhet fjalë për Brinjët e Kreshtës, një zonë jo me bimësi intensive dhe jo me bimësi të rritur. Komisioni ra dakord dhe ju fton të gjithëve që të japim dakordësinë për dhënien me qera të kësaj sipërfaqeje, me afat 10-vjeçar plus të drejtë rinovimi.

- Ndue Lulu: Fjala për kryetarin e Komisionit të Financës,

- Agostin Marku: Edhe komisioni i Financës e diskutoi këtë projekt vendim dhe ka dy vërejtje, që kërkon dhe të ndryshohen. Te pika 2 afati për dhënien në përdorim do të jetë 10 vjet

me të drejtë rinovimi. Të përcaktohet edhe koha e rinovimit, sa. Dhe te pika 6 – për zbatimin e këtij vendimi – mos të futen drejtoritë por – Këshilli i Bashkisë nuk ngarkon drejtoritë, i ngarkon kryetari i Bashkisë, pra për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë. Është bërë dhe konsultimi publik, bashkë së bashku me këshillin, ka qenë prezent një pjesë e mirë e banorëve të zonës, kanë ngritur shqetësimet, të cilat përputhen edhe me strategjinë, edhe me projekt vendimin, janë bërë të cilat janë të përcaktuara këtu dhe sa i takon referencave ligjore jemi në rregull, me këto rregullime edhe komisioni i Financës ishte dakord që të kalojë. Faleminderit.

– Ndue Lufi: Kush ka pyetje? Z. Përgjoka.

– Emanuel Përgjoka: Duke parë trendin që në të gjithë Shqipërinë, qeveria po jep det, mal, sikur tha dhe ish zv/kryeministri në orarët, kjo gjë po vjen dhe në Lezhë, dhe ne po fillojmë, kemi mbaruar punë me bregdetin, ne kemi ngelë ca zona të vogla, por gati kemi mbaruar punë, po fillojmë dhe me malet. Shpresoj ide biznesi, shumë fjalë interesante, por ideja është që a ka bashkia një plan biznesi të atij biznesi se sa fiton ai biznes. Po te studimi, në të gjitha Europën, këto lloj bizneset, bashkive u paguajnë

nga përpjesëtimi e fitimit, gjë si këtu, pra thotë, 8 ha tokë dimë, plus rrugë e të tjera dhe studimi këtu se do marrim 2 371 410 lekë në vit.

Pyetja është: A ka bashkia një plan fitimi përveç këtij apo ka veç me e dhënë me pra, s'ka rëndësi se sa fiton ai.

- Ndue Luli: Atëherë vazhdojmë me pyetjet. Znj. Marku.
- Alfrida Marku: Në vijimësi të pyetjeve për Emanuelin, z. Dod e ju keni 8 ha apo 15,3 sepse këtu ka 8 ha që përbëhet nga sheshet e aerogjeneratorëve me sipërfaqe shtesë që i dedikohet gjatë këtij projekti dhe po t'i mbledhësh, shkon 15,3 ha. Relacioni, për mendimin tim, veç relacion nuk është. Thuhet që studimin e ka bërë e njëjta firmë e cila kërkon që të marrë në përdorim këtë sipërfaqe. Ju e thoni kot që kjo procedurë do t'i nënshtrohet rregullave të prokurimit publik sepse qartë që në fillim, që në këtë relacion, që në këtë projekt vendim, gjë e keni marrë që është një procedurë me fitues të paracaktuar. Ju nominoni subjektin, KIRAÇ GREEN ENERGY shpk, po e shoqëru me NIPT përkatës, ku secili nga ne të kishte mundësinë me verifiku aktivitetin që kryen ky subjekt, gjendjen ekonomike, kapacitetin që ka ky subjekt për të zhvillu këtë aktivitet. Unë bëjë kërkim të thjeshtë bëra dhe del subjekt që në vitin 2019

ka nisë procedurat e falimentimit. Me këto të dhëna, duke mbajtur rezervë që nuk kishte NIPT për të saktësuar, na ju filloni procedurë me fitues të paracaktuar, kundër rregullave të prokurimit publik, me një subjekt, i cili, me aq sa kërkova unë, del në proces falimentimi në 2018. A ka një relacion nga ekspertë për impaktin mjedisor? Unë mendoj që ka një disbalancë midis vlerës së pronës publike që jepet dhe përfitimit që ka bashkia. Nuk qëndron themeli këtu. Themeli është favorizimi i subjekteve të caktuara duke e keqpërdorur pronën publike. Unë jam kundër për këtë projekt vendim.

- Ndue Luli i Qarkut. Fjala për z. Marku.

- Agostin Marku: Vetëm një sqarim për sa i përket vendimit. Ne nuk marrim vendim sot se kujt do t'i jepet ajo sipërfaqe. dhe në asnjë rresht, asnjë pikë, asnjë nen të p/vendimit nuk ka të shkruar "kompani". Në asnjë strategji nuk ka të shkruar kompani". Në relacionin e drejtorisë përkatëse është përmendë një subjekt i interesuar i cili ka bërë një vëzhgim dhe ka shprehur një interes. Ka një tarifë e caktuar mbi bazën e VKM dhe përcakton vlerën e qerasë vjetore, e cila dhe kjo nuk është fikse sepse tendencohet dhe ajo kompani ka bërë një studim, ka shprehur një interes, por mund të vijë nesër, që ne nuk

e dimë asnjë, besoj as kryetari i Bashkisë nuk e di, mund të vijë një kompani tjetër shumë më e fuqishme dhe mund ta marrë me një vlerë sa 5-fishi, 10-fishi i asaj që është përllogaritur këtu dhe e hedh poshtë këtë kompani, këtu s'kemi të drejtë paragjykimi, fare. Relacioni, është relacion në kuadrin e transparencës me atë që ka bërë Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Drejtoria e Bujqësisë, për ta ndajmë, ne nuk miratojmë sot as kompani, a është fallco, a s'është fallco, po ka shprehur një interes, bashkia ta japë që të gjenerojë të ardhura, ne kemi po sepse kushdo që ta marrë do investojë në përmirësimin e kushteve në menaxhimin e pyjeve në atë zonë. Kaq kemi në dorë ne.
Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Ta sqarojmë se pediturie kujon shumë mjegull. E para e punës, n.p.s është përmendë një kompani, nuk ka lidhje me ndonjë skemë tonën që fantazojnë ca, por është me ligjin për investimet strategjike, paket propozim i paketuar, që një subjekt x e bën dhe këtu nuk ka asnjë shkelje. E dyta, është ajo që tha Apostini, nuk e trajtojmë ne, e trajton AIDA me Komitetit e Zhvillimeve Strategjike ku është kryeministri në krye. Shprehet Ministria e Energjitikës dhe Industrisë dhe çelohet një e për një. Ne kemi një fond pyjor të cilin e

administrojmë ne si bashki. Ai sot është jorentabël,
nuk prodhon asgjë për bashkinë. Çështja e tarifave
që këtu nxirret si klauzolë duke shfaqë parakushti
tjetër, është e rregulluar me VKM, n.q.s kur ka
hyrje në ankand një kompani do të ofrojë më
tepër se sa ka përcaktuar VKM-ja, kjo është
çështje tjetër. Por është e rregulluar, nuk është
se e rregullojmë ne këtë punë. dhe në VKM është
e përcaktuar shuma se sa do paguhet për dhënien
e fondit pyjor. Ne japim miratimin nëse do
bëhet ky zhvillim atje, dhe është një zhvillim në
fushën energjitike dhe sa për dijeni, ne ~~[illegible]~~
sot japim vetëm pëlqimin se për të shkuar deri
te investimi ka disa procedura të tjera. Ndoshta
i bie që dhe mos të bëhet, po ça rëndësi ka.
Rëndësi ka që ne si komunitet të përfitojmë,
përveç taksave të infrastrukturës në ndërtim,
përveç qerasë që marrim ne përfitojmë dhe
investime në komunitet. Një biznes i tillë që
ka të bëjë me energjitikën është në gjithë botën,
Plus që sistemi energjitik në zonën ku do të bëhet,
do jetë super i stabilizuar sepse ne do e kërkojmë
si klauzolë, një, dy, tre, rruga, shkolla, qendrën,
sistemi energjitik i zonës ku bëhet, të gjitha bashkë
do futen në paketë, ku ne do përfitojmë me
cilësinë e komunitetit, për shkak të investimit.
Se çfarë përfaqëson kompania, nuk jam në gjendje

ta them. Ekspertët ndërkombëtarë e dinë. [këta] Por AIDA te investimet strategjike e skanon fije për fije dhe është detyrë e saja, jo e imja.

- Ndue Luli: Faleminderit.

Fjala për pyetje.

- Donika Hoxhia: Në fakt unë do e shikoja në një plan tjetër, nuk do futem fare te financat, por poshtë sipërfaqen e tokës. Edhe unë lexova diçka për këtë komponentë, në fakt me një emër pak sa më të shkurtër më dilte diku, por për këtë gjë ekziston masa në Poliçan dhe nuk ka bërë asgjë akoma, gjithsesi e lëmë, e kemi se nuk do jetë ajo, pak rëndësi ka. Në fakt unë jam kundër një projekti të tillë sepse sado që të fitojmë në vlerë monetare, duke parë përmasat e Shqipërisë sonë, nuk mendoj se është e nevojshme, duke parë hapësirën e bregut tonë, nuk e shoh të nevojshme. U tha a ka pemë 2-3 metërshe, nuk janë tepër ato, edhe shkurret. Nëse ne do të na trembë një zonë e linë e virgjër sepse s'e ka prekur kërkush, kjo do të ishte e tmerrshme. E kam për ekosistemin, nuk po futem në biznes fare. Dmth ne mund të fitojmë diçka dhe jam dakord, a ia vlen përballë ajrit, ne kemi detin por kemi nevojë dhe për këto gjërat e tjera. Janë shumë 15 ha. Këto i kemi parë nëpër

botë gjithkund, por nuk jemi ne sa bota.
- Pjerin Ndreu: A te sparoj pak.
- Donika Hoxhia: Unë jam kundra, por jo kundër zhvillimit.
- Pjerin Ndreu: Jo, kjo është kundër zhvillimit. Është një gjë që është futur si standart sot, është green energy, domth energjie që vjen me panele diellore etj. Ça problemi ke? Nuk prishet asgjë. E ke gjithë bota ky është standart investimesh nga më të mirat, nga më dinjitozet që bëhet në një biznes, dhe ne nuk kemi asnjë arsye që të ndalojmë çdo lloj biznesi që vjen në Lethë dhe bën oferta për të zhvilluar diçka në Lethë, a në fushën energjitike, a në fushën e industrisë së lehtë, a në fushën e industrisë së rëndë, a në turizëm. Ne japim pëlqimin se është tokë e jona dhe është kot aty, për sa kohë ata japin garancinë që nuk do prekin asgjë aty, nuk do cënojë ekosistemin. Nuk dua unë - këto nuk janë muhabete këshilli, duhet të thuash argument.
- Donika Hoxhia: Unë oksigjenin e kam argument.
- Pjerin Ndreu: Po s'ta mbyllin oksigjenin me atë gjë për mullinjtë e erës, se është kerp tani
- Donika Hoxhia: Po priten shkurret.
- Pjerin Ndreu: Nuk priten shkurret, që batament sa kanë ata, nuk pritet asnjë shkurre.

12 copë bëhen gjithsej. Imagjinoj, 12 copë, sa barament kanë, është e papërfillshme fare.

- Ndue Luli: Fjala për z. Ndreca
- Erin Ndreca: Po marr fjalën, përderisa kam fatin të punoj në një punë ku prodhohet energji elektrike, që janë hidrocentralet dhe ~~#~~ dua t'ju shpjegoj juve dhe opinionit se mirë the kryetari, janë të paditur dhe krijohet mjegull. Ju lutem lexoni me kujdes gjërat. E kam dhe për z. Përgjoku që pyeti. Përfitimet janë të gjitha të parashikuara në ligj, përfshirë dhe taksat që do i paguajë bashkisë. E dyta, përfiton e gjithë Shqipëria sepse për të transmetuar atë energji, që do futet në linjët e interkoneksionit ku paguan, që the ti, dua ta shpjegoj, prandaj them të lutem më lër të flas sepse e kam një përvojë, por dua edhe t'ju zbuloj juve që po flisni kot.
- Donika Haxhia: Ti me rregullo të folurën zotëri; Ti ke të drejtë të marrësh mikrofonin dhe mos të komentosh mënyrën se si flas unë. Nuk ta lejoj. Ti je inxhinier dhe di më shumë se unë. Jam ok. Në komunikim të lutem moderohu.
- Erin Ndreca: Ju po thoni gjithë këto gjëra, po paragjykoni dhe tani na bëni dhe moral.

- Ndue Luli: z. Ndreca të lutem përmbylle diskutimin.
- Erin Ndreca: Çdo përfitim i atyre është totalisht i matur dhe matet nga sistemi i transmetimit dhe ata do paguajnë pikë për pikë. E dyta. Ne kemi energji mjaftueshëm tha profesoresha. Energjia nuk akumulohet. Ka perindha të caktuara kur ka resurse të shumta që ka energji më shumë por që dhe e shet. Por ka momente që nuk ka energji dhe për të prodhuar energji nga burime të ndryshme, që më tepër nga green energy është standart. Të gjithë ata që investojnë në këtë fushë, e 10-fishojnë numrin e bimëve që dëmtohen për shkak të investimit.
- Ndue Luli: Fjalën e ka z. Tushaj, pastaj z. Ndreca. Se më shkurt ju lutem se mos të dalim te komentet e këshilltarëve kur të flasin. Secili ka mendimin e vet, pastaj ka kartonin.
- Pjetër Tushaj: Ne po flasim shumë gjëra që duhen të bëhen këtu në bashki dhe s'po ka kundërshtim njeri, megjithatë po flasim për këtë temë tani. Ndoshta dikush ka mendimet e veta të drejta por gjithsesi çdo individ, biznes jep diçka me para dhe çdo gjë e dhënë me para, ka një fitim. E kam lexu shumë mirë këtë pjesë. Po flitet për një zonë atje në kreshtë edhe n.p.s ajo zonë nuk ka probleme pronësie, probleme me

ekosistemin, nuk është asnjë e keqe. Atje ka do jepet me para. Sot është kyçtar bashkia Pjcin Ndreu, nesër ose pasnesër vjen një fitues, s'ka rëndësi, ajo punë do jetë e pikhershme për komunitetin ka probleme, për do të marri lekë e kyçtar. Flitet për një parcelë pyjore për inxhinierët e kanë studjuar. Unë personalisht do të votoj sepse ajo punë është shumë e mirë, ka në Kroaci, në Mal të Zi, në Gjermani.

- Ndue Luli: Fjala për z. Arton Ndreu.

- Alfride Marku: Një fjali mqs kam mikrofonin afër. Që të mos keto keqkuptime. Askush nuk është kundër mullinjve të erës apo paneve fotovoltaike për fomë mënyra alternative të prodhimit të energjisë elektrike. por ajo që kërkojmë ne është procedura e saktë dhe e bazuar në ligj. A mund të kemi një NIPT të këtij subjekti? Si mund të kalojmë ne një procedurë të tillë pa e ditë kush është ky subjekt.

- Ndue Luli: Fjala për z. Arton dhe pas tij e kam një fjalë unë dhe radhën këtu, e di secili, e mbaj unë, për diskutimin.

- Arton Ndreu: Desha të bëj një kërkesë për çdo këshilltar për cinizmin ose ofendimin. Në lidhje me këtë p/vendim, e kemi diskutuar dje në komision. Ne diskutojmë këtu për shkulljen e tereave dhe nuk kapim thelbin. Ne jemi

për dakordësinë, a do bëhet, a s'do bëhet.
Unë kisha dëshirë të dëgjoj nga drejtoria përkatëse a cënohet privati.
- Ndue Luli: Drejtoria përkatëse shumë shkurt, 1 minut kohë ka, mepsë e kërkon këshilltari.
- Ercaldo Smeçi (drejtori Bujqësisë) - Po jap një shpjegim shumë shkurt. I kam mbajtur të gjitha pyetjet, po i përmbledh. Në lidhje me sa fiton, ne e llogaritim me sipërfaqe, jo me vlerën sa fiton vetë firma. E dyta, këtu diskutohet se ne e parashikojmë firmën fituese. Ligji e përcakton qartë që për t'u futur në një procedurë ankandi, duhet të inicojë dikush dhe kjo është një nga firmat që mund të inicojë, ndoshta s'është kjo, mund të jetë çdo lloj firme për të filluar procedurat e ankandit. Dhe a ka ndikim në mjedis - Çdo lloj firme e cila futet në procedurë ankandi ka vlerësimin e ndikimit në mjedis nga një subjekt i liçencuar. Pika 10 e Udhëzimit Nr.1 të vitit 2016 e përcakton kur duhet paraqitur NIPT-i, plan biznesi i cili do të investohet, leje mjedisore, gjurmimin e gërmimit, pra është e përcaktuar për të gjitha firmat që do futen në konkurim. Pyetja e fundit, a ndikon ky park te sipërfaqja e pronave private - në momentin që është pronë private, nuk merret vendim këshilli, po të jetë private hyjnë direkt në marrëdhënie kontraktuale. Në këshill merret

vendim ose hidhet në diskutim vetëm për pronën
që zotërohet nga bashkia dhe kjo pronë që po
diskutojmë është e bashkisë me Vendim të Këshillit
të Ministrave. Sa i përket pronës që preket,
sipërfaqes pyjore, kjo kryesisht mbajë e Kreshtës,
që fillon nga njësia Ungrej dhe përfundon në
Blinisht, kryesisht ka bimësi sporadike të llojit
shkurre, nuk ka fare lis e as pishë, është
parë në terren dhe të gjitha janë të fotografuara.
Siç e tha dhe kryetari janë 12 aerogjeneratorë
dhe e ka dhe te pika 10, ku thotë dhe mbas
mbarimit të afatit të kontratës, n.q.s nuk do
rinovohet, ka dhe planin e rehabilitimit të
kësaj sipërfaqeje dhe kthimin në gjendjen e mëparshme.
dhe ka detyrim ligjor të pyllëzojë 3-fishin
e kësaj sipërfaqeje.

- Ndue Luli: Duke qenë se dhe unë jam një nga
këshilltarët si ju, dua t'jua them hapur që
për çdo p/vendim që vjen i natyrës së dhënies
së pronës të tretëve, kuptohet, për të mirën
e komunitetit, siç është ky rast, n.q.s
diskutimet që bëhen në ato konsultimet publike
do jenë tamam sipas rregullave e ligjeve, unë
do isha fitimonë pro marrjes së këtyre vendimeve
duke kaluar dhe komisionet përkatëse. Ne
kërkojmë megjithëse prapë gjëra që u deklaruan
këtu, ashtu siç e deklaroi në fund edhe drejtori,

Doketë dhe herë të tjera vendime të tilla.
- Pjetrin Ndreu: Një spanja n.p.s ke mundësi.
E para e punës, këto janë investime bashkëkohore për inxhin gjithë sistemi i Shteteve të BE-së, nuk është një shpikje lezhe. Fatkeqësisht te ne nuk janë bërë akoma. Kemi minetu ne në Mal të Shëngjinit e koncesionit por nuk është bërë për arsye se kanë dhe investime të mëdhaja. Unë e di se do ketë kësillterë për do mundohen me bë politikë me këtë, do ketë njerëz të tjerë për do mundohen me shpik historira. Toka "është e bashkisë". Në këto diskutime, ne nuk pretendojmë për të jenë të gjithë dakord se edhe kur është bërë Kulla e Parisit është bërë nami i zi se s'kanë qenë dakord të gjithë por ajo është bërë dhe në fakt është ajo që "është". Ne nuk do të lëshojmë pe askund në përfitimet tona si bashki. Ne kemi ardhur këtu dhe përfaqësojmë të gjithë interesat e komunitetit. Unë e përgëzoj Pjetrin për e thotë parti, më thjesht nuk ke. Ajo (shikohet) përcaktohet te AIDA, jo këtu, këtu shikohet a jam apo jo dakord me e dhënë me pare dhe unë s'kam përcaktu firmën se cila. Ajo ka bërë propozimin e paleçkuar dhe ka shprehë interes. Nesër kur të shpallet ankandi, çohen dhe 5 firma të tjera. Kjo është një

politikë zhvillimi dhe të thuash që nuk je dakord
të miratosh një politikë zhvillimi të green energy ...
më falni. Ne nuk mund të ngelemi në politikën
e zhvillimit me e tekave të kërkujt që mendon
se me tokën e shtetit ... se toka pyjore është
tokë shtet, kush ka ëndrra në botë që ose
e ka pasë dikun, të shkojë të bëjë letrat
se i kam dëgjuar banorët - jo po s'dua unë.
Po kush je ti. Disponuesi i tokës është bashkia.
Pronari i tokës është Bashkia Lezhë, edhe
nuk është as Kryetari i Bashkisë. Këshilli
Bashkiak është ai që me vendim e jep apo
s'e jep tokën. Unë e mirëkuptoj edhe zyshën
se ashtu e mendon. Ndoshta Erini e di
më mirë si profesion se ça përfitimesh e të
tjera por që të jetë e dëmshme, nuk ndodh.
Se i ke kudo. Të gjitha këto politika zhvillimi
në zonën tonë, ku me e marrë, të vijnë, ithella
e kemi seriozisht, po ne thjesht themi po,
ne atë tokën mund ta japim e nuk është
se nesër fillon pereja. Ehuu sa punë ka.

- Ndue Luli: Faleminderit. Z. Troshaj 30 sek. kohë,
- Alfons Troshaj: Unë kam qenë në dëgjesën publike të kësaj pike, ku na është bërë thirrje të gjithë këshilltarëve të marrim pjesë, të dëgjojmë publikun, ata shprehën mendimet e tyre, drejtoria i sqaroi me pikë edhe me presje. Kjo nuk

është diçka që s'e ka bërë kërkush në botë.
Kena nderin për një nga firmat dhe jep lekë
për bashkinë tonë, por bashkia të bëjë ato
veprimet e veta, të paguajë pyetësorët nga
afër sepse ato kishin nevojë të sponsorizohen nga
afër. Unë kam takuar pyetësorët atë ditë
dhe kam ikur direkt në majën e kreshtës
me makinë dhe aty nuk ka bimësi, ka shkurre
Unë them që çdo këshilltar të shkojë të
shikojë realitetin vetë.
- Ndue Luli: Faleminderit z. Trashaj.
Fjala e fundit znj. Ndoj, 20 sek.
- Donika Ndoj: Unë në fakt e kisha me
komunikimin, në cilësinë e kryetares së
Aleancës së Grave Këshilltare, unë kërkoj
që ne të respektojmë shumë mendimin e njëri-
tjetrit, të vlerësojmë atë, të ruajmë etikën
e komunikimit, asnjë nuk është i paditur këtu,
në profesionin tonë të gjithë jemi të ditur.
ndaj unë kërkoj nga të gjithë të respektojmë
njëri-tjetrin, sidomos që jemi dhe live
- Ndue Luli: I qartë mesazhi. Jam dakord
me mesazhin tuaj.
Kush është dakord me projekt vendimin?
Miratohet me 25 vota PRO
Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi
Këshilltarët Emanuel Përjaku, Donika Ndoj,

Donika Hexhia, Flutura Gjoni dhe Alfride Marku votuan kundër (5 vota)

- Z. Pjerin Ndreu foli rreth politikëbërjes në këshill.
- Ndue Luli: Kalojmë te pika 15 që është projekt vendim "Për ngritjen e këshillit të ri artistiko-kulturor dhe turistik, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore artistike dhe turistike në Bashkinë Lezhë"".

Fjala për kryetarin e komisionit, z. Trashaj.

- Alfons Trashaj: Ne si komision e shqyrtuam, patëm dhe drejtorinë përkatëse që na sqaroi dhe ne ramë dakord.
- Agostin Marku: Diçka në lidhje me rregullimet
Aty ku është shumë "të ri" do të hiqet se ne miratojmë këshillin, jo i ri, i vjetër,
Tek anëtarët, ato pozicionet, botues etj, të hiqen.
Tek pika 2 duhet "mandati ...... ... për çdo mbledhje, por jo më shumë se 6 mbledhje" - pjesa tjetër hiqet, pra riformulohet pika 2.
Shtohet pika 6 - ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
Pra me këto ndryshime, rregullime nuk prishet esenca.
- Largohen këshilltarët Emanuel Përgjoni, Donika Ndoj.
- Ndue Luli: Kush është dakord me miratimin e p/vendimit me këto ndryshime të vogla teknike?

Miratohet me 28 vote PRO.
Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.
- U largua kryetari i Bashkisë.
- Ndue Luli: Kalojmë te pika 16 që është projekt vendim "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr. 13, datë 27.07.2023 "Për miratimin e pagave të administratës së bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve të varësisë, të punonjësve të njësive mbështetëse, të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave" i ndryshuar".
- Agostin Marku: S'është ndryshuar asgjë. Ka të bëjë me një projekt që e ka fituar bashkia dhe janë disa të punësuar. Përcaktohen pagat e fitueselit prej tyre. Futet te Lidhja Nr. 1. Shtohen dy zëra për kohë të pjesshme dhe atashohet dhe te klasifikimi i pagave dhe s'ka asgjë tjetër, dhe këto pastaj pasohen nga p/vendimi që shtuam në rendin e ditës me shpenzimet financiare që duhen për të përballuar këtë projekt, se i takon bashkisë dhe pjesën që vjen nga Ministria e Shëndetësisë, që është i fituar nga Ministria. Sqarimet ishin për të dy p/vendimet më.
- U largua këshilltari Klevis Bezhi.
- Ndue Luli: Ka dikush diçka tjetër? Atëherë meqë nuk ka, kush është dakord me projekt vendimin?

Miratohet me 27 vota PRO.
Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.
Kalojmë te pika 17 që është projekt vendim "Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe të parashikimit afatmesëm të të ardhurave".
- Agostin Marku; Është një kërkesë e ligjit. Këtë e morëm në shqyrtim herën e kaluar si raport. Ligji e parashikoka që ai raport duhet të paraqitet në trajtën e vendimit. Është sjellë nga Drejtoria e Taksave p/vendimi dhe duhet ta miratojmë.
- U largua këshilltarja Fjoralba Zefi.
- Ndue Luli: kush është dakord me p/vendimin?
Miratohet me 25 vota PRO.
Këshilltarja Donika Haxhia abstenoi.
Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.
Vazhdojmë me projekt vendimin tjetër në pikën 18 "Për miratimin e buxhetit faktik të Bashkisë Lezhë për vitin 2023".
- Agostin Marku: Janë shifrat që paraqet bashkia pas rakordimit përfundimtar për vitin 2023 me të ardhurat, me shpenzimet faktike. Një kërkesë e ligjit që duhet të miratojmë buxhetin faktik të vitit 2023. Nëse dikush ka ndonjë pyetje, mund t'i drejtohet drejtorisë përkatëse, por besoj që është diçka e mbaruar, por duhet sipas

kërkesës së ligjit për të miratojmë shifrat përkatëse. sipas asaj që ka parapitur bashkia.
- Ndue Luli: ka ndonjë mendim?
Meqë nuk ka, kush është dakord me plotësimin?
Miratohet me 24 vota PRO.
Këshilltarja Donika Hoxhia abstenoi.
Këshilltarët Aleksandër Mekaj, Alfrida Marku nuk votuan.
Kalojmë te projekt vendimi shtesë që është "Për një shtesë në VKB nr. 70, datë 14.12.2023 "Për miratimin e PBA-së 2024-2026 dhe Buxhetit të vitit 2024" dhe përdorim të fondit të akorduar nga MSHMS." që ka lidhje me p/v që kaluam më parë në pikën 16.
- Agostin Marku: Unë e konsumova si problem Ta miratojmë sepse janë fonda që duhen për pagat. Janë të projektit.
- Ndue Luli: kush është dakord me plotësimin?
Miratohet me 26 vota PRO.
Këshilltari Aleksandër Mekaj nuk votoi.
Faleminderit.
Për "Të ndryshme" a ka?
Po znj. Marku.
- Alfrida Marku: Unë po e nis dhe me shumë pak kërkoj që në mbledhjen e radhës të këshillit të përfshihet në rendin e ditës interpelancë me kryetarin

e Bashkisë" mbi rrugët rurale dhe urbane që janë në zbatim dhe që parashikohen të realizohen rishtas këtë vit, shoqëruar me projektet.

- Ndue Luli: Është e drejtë e çdo këshilltari për të kërkuar interpelancë, kështu për bëni shkresën përkatëse dhe çështje realizohet.
E qartë.
Probleme të tjera? Nuk ka.
Ju falenderoj.

- Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".

| | |
|---|---|
| SEKRETARI | KRYETARI |
| FLORIDA ÇUNAJ | NDUE LULI |